



Raport përfundimtar

Mbi veprimtaritë e zhvilluara nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në përmbushje të objektivave të projektit:

“MBROJTJA E TË DREJTAVE PRONËSORE TË GRAVE DHE VAJZAVE NË SITUATËN E DËMTIMEVE NGA TËRMETI”

Bashkitë:

Lezhë
Durrës
Kurbini
Kamëz

Mirditë
Shijak
Rrogozhinë
Krujë

Tiranë
Kavajë
Vorë



Raport përfundimtar

Mbi veprimtaritë e zhvilluara nga
Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në përmbushje
të objektivave të projektit:
**“MBROJTJA E TË DREJTAVE PRONËSORE TË GRAVE
DHE VAJZAVE NË SITUATËN E DËMTIMEVE NGA TËRMETI”**

**Bashkitë: Lezhë, Mirditë, Tiranë, Durrës, Shijak, Kavajë, Kurbin,
Rrogzhinë Vorë, Kamëz dhe Krujë**

Periudha e zbatimit: 23 Qershor 2021-31 Gusht 2022.

Tiranë, 2022

GUSHT 2022

Ky raport është përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, në kuadrin e projektit “Për rimëkëmbjen dhe rindërtimin pas tërmetit me ndjeshmëri gjinore”, i cili zbatohet nga UN Women dhe mbështetet financiarisht nga Qeveria Suedeze përmes fondit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e autorëve dhe në asnjë rast nuk reflekton apo përfaqëson domosdoshmërisht mendimin apo qëndrimin e UN Women dhe as të Qeverisë Suedeze.

Përgatitën raportin: Prof. Dr. Av. Aurela Anastasi; Av. Iris Aliaj

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Adresa: Rr. Vaso Pasha, Pall.12, Shk.1, Ap.1, Tiranë

Email: avokatore2@yahoo.com

Web: www.qag-al.org

Përmbajtja e lëndës

Shkurtime	5
Metodologjia.....	6
1.NDËRGJEGJËSIMI DHE EDUKIMI LIGJOR PËR GRATË DHE VAJZAT E PREKURA NGATËRMETI.....	7
1.1 Organizimi i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Lezhës. Gjetjet.	7
1.2 Organizimi takimeve derë më derë. Gjetjet.	9
2. GARANTIM I NDIHMËS JURIDIKE FALAS	10
2.1 Ofrimi i ndihmës juridike parësore	10
2.1.1 Lloji i ndihmës juridike parësore i ofruar	11
2.1.2 Objekti i çështjeve të ndihmës juridike parësore	11
2.2 Ofrimi i ndihmës juridike dytësore.....	13
2.3 Përrjashtimi nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore.....	13
2.4 Gjetje dhe konkluzione të evidentuara nga avokatët gjatë ofrimit të shërbimit ligjor falas.	13
3. RRRITJE E KAPACITETEVE TË PUNONJËSVE TË AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS, TË BASHKIVE E NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE NOTERËVE.....	16
3.1 Organizimi i trajnimeve të kombinuara.....	16
3.2 Trajnime (on job) në zyrat e punonjësve. Gjetjet.	16
3.3 Adresimi i zgjidhjeve për problemet e evidentuara.....	18
4. AKTIVITETE AVOKUESE DHE LOBUESE ME AKTORËT PËRGJEGJËS.....	19
4.1. Takime dhe komunikime me organet kushtetuese që mbrojnë të drejtat e njeriut.....	20
4.2. Takim me përfaqësues të pushtetit qendror.....	21
4.3. Takime me përfaqësues të pushtetit vendor	22
4.4. Takime me përfaqësues të drejtorive vendore të kadastrës.....	22
4.5. Takim me kryetaren e Dhomës Kombëtare të Noterëve.....	23
4.6. Hartimi i manualit për juristët.....	23
4.7. Gjetje dhe Konkluzione.	23
5 ANGAZHIMI I JURISTËVE TË RINJ NË AKTIVITETET E PROJEKTIT.....	25

5.1 Përgatitja e studimit (desk study)	25
5.2. Takimet derë më derë me gratë dhe vajzat në zonat e dëmtuara nga tërmeti.....	26
5.3 Organizimi i një trajnimit me juristët/juristët e rinj.....	26
 6. AKTIVITETE TË TJERA TË ORGANIZUARA NË ZBATIM TË PROJEKTIT	27
6.1 Organizimi i një Workshop-i	27
6.2 Retreat i stafit të QNL-së	27
6.3 Përgatitja e raportit përfundimtar	27
 7. SFIDAT E HASURA NGA QNL GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT	28
 8. PËRFUNDIME TË PROJEKTIT DHE REKOMANDIME	29
 ANEX 1.	30
Procesi i rindërtimit sipas informacioneve të disa bashkive përgjegjëse.....	30
 ANEX 2.....	33
Aktet ligjore e nënligjore	33

Shkurtime

OJF	Organizata Jofitimprurëse
QNL	Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
NJ	Ndihmë juridike
AP	Avokati i Popullit
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
MD	Ministria e Drejtësisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Noterisë
MR	Ministria e Rindërtimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Metodologjia

Ky raport është një përmbledhje e të gjitha veprimtarive kryesore që Qendra për Nisma Ligjore qytetare ka zhvilluar në kuadrin e zbatimit të projektit “Për rimëkëmbjen dhe rindërtimin pas tërmetit me ndjeshmëri gjinore”. Raporti synon të sjellë në vëmendje përvojat dhe problemet e evidentuara. Janë pasqyruar raste dhe gjetje nga ofrimi i ndihmës ligjore falas për gratë dhe vajzat në zonat e dëmtuara nga tërmeti; nga aktivitetet për edukimin ligjor për të drejtat dhe detyrat e shtetasve në zonat e prekura nga tërmeti, veprimtaritë për zbatimin e legjislacionit të posaçëm për shmangien e pasojave të tërmetit; nga aktivitetet për forcimin e kapaciteteve të institucioneve, si dhe punës për përmirësimin e legjislacionit dhe të zbatimit të tij nga institucionet shtetërore përgjegjëse.

Metoda kryesore e përdorur për shkrimin e raportit është metoda analitike dhe sintetizuese e aktivitetit të kryer, me qëllim evidentimin e gjetjeve dhe konkluzioneve për adresimin e problemeve dhe përmirësimin e mëtejshëm të punës. Janë përfshirë metodat desk study, intervistat me gra dhe vajza të komunitetit në zonat e dëmtuara nga tërmeti, intervistat me përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse, si dhe analiza për të nxjerrë konkluzione nga ndihma ligjore falas.

Gjetjet e evidentuara përmes intervistimit të punonjësve dhe përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse në procesin e rindërtimit, të cilat janë pasqyruar në aneksin e këtij Raporti¹, kanë ndihmuar ekspertët dhe juristët e projektit që të identifikojnë problemet dhe konfliktet juridike, e në veçanti ato që lidhen me parimin e barazisë gjinore, me qëllim që t’i adresonin në rrugën e duhur të parandalimit ose të zgjidhjes.

Gjetjet dhe konkluzionet e dala nga ky raport përmbledhës shërbejnë për të nxjerrë mësim, për veprimtarinë e institucioneve shtetërore vendore e qendrore, që vijojnë të kryejnë detyrat e tyre ligjore në zonat e dëmtuara nga tërmeti, për të mbështetur gratë dhe vajzat derisa të gëzojnë të drejtat e tyre mbi pronësinë e përfituar si rezultat i rindërtimeve në këto zona.


¹ Shih “Procesi i rindërtimit sipas informacioneve të disa bashkive përgjegjëse” Aneks i këtij raporti.

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi ligjor për gratë dhe vajzat e prekura nga tërmeti

Në kuadër të organizimit të tridhjetë e pesë takimeve ndërgjegjëse dhe tetëdhjetë takimeve derë më derë, gratë dhe vajzat e prekura nga tërmeti në zonat e mbuluara nga projekti janë më të informuara për legjislacionin e rindërtimit, procedurat, fazat e aplikimit, institucionet përgjegjëse dhe për regjistrimin e pronës në emër të tyre. Gjithashtu, ato janë informuar për të drejtat e tyre pronësore, mjetet ligjore, si dhe për rëndësinë e regjistrimit të pronave nën emrin e tyre si bashkëpronare.

Nga organizimi i aktiviteteve të mësipërme kanë përfituar 474 (katërqind e shtatëdhjetë e katër) gra dhe vajza të prekura nga tërmeti. Ndërsa, nëpërmjet platformës *on line* të QNL-së janë informuar për të drejtat pronësore dhe aktivitetet e projektit rreth 964 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër) gra dhe vajza, si dhe qytetarë të tjerë.

Grafiku. 1



1.1 Organizimi i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjëse në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Lezhës. Gjetjet.

35 (Tridhjetë e pesë) takime ndërgjegjëse janë organizuar në Bashkitë dhe njësitë administrative përkatëse si vijon: Durrës, Fushë-Krujë, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Qerret, Rrogozhinë, Pezë, Shijak, Tiranë-Vaqar, Thumanë, Vorë.

Në takime kanë marrë pjesë 394 (treqind e nëntëdhjetë e katër) gra dhe vajza të dëmtuara nga tërmeti, njohuritë ligjore të të cilave janë rritur lidhur me legjislacionin e posaçëm të rindërtimit,

procedurat ligjore, fazat e aplikimit si dhe të drejtat dhe detyrimet për të përfituar nga këto programe. Ato janë më të informuara për hapat që duhet të ndërmerren për regjistrimin e pronave bashkëshortore edhe në emër të tyre, në kujdesin që duhet të tregojnë nëse nënshkruajnë kontrata të ndryshme përpara noterit, disponimin e pasurisë nëpërmjet testamentit, shitjes, dhurimit etj, për të drejtat e tyre si trashëgimtare, të drejtat në pronat në proces legalizimi, si dhe për të drejtat mbi tokën bujqësore.

Gjatë këtyre aktiviteteve u identifikuan edhe raste që kishin nevojë për ndihmë ligjore falas, ndihmë që u garantua nga avokatët e QNL-së.

Të dhënat për sa më sipër janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Qytetet/Njësitë Administrative	Numri i aktiviteteve informuese	Numri i pjesëmarrësve
Durrës	6	36
Fushë-Krujë	2	36
Kavajë	1	20
Kamëz	2	36
Krujë	2	11
Kurbin	2	23
Lezhë	6	41
Mirditë	2	28
Qerret	1	15
Rrogozhinë	2	27
Pezë	1	16
Shijak	2	27
Tiranë - Vaqar	2	36
Thumanë	2	14
Vorë	2	28
Totali	35	394

Tabela nr. 1

Gjithashtu, nëpërmjet mediës sociale të QNL-së janë informuar rreth 964 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër) qytetarë për legjislacionin e rindërtimit, të drejtat pronësore në këndvështrimin gjinor si dhe çdo aktivitet të organizuar në kuadër të zbatimit të projektit.

Gjetjet nga takimet ndërgjegjëse. Nga takimet informuese ka rezultuar se gratë dhe vajzat nuk janë të regjistruara si bashkëpronare në regjistrat e Kadastrës dhe se kryesisht, vijojnë që të jenë burrat pronarë të banesave, të cilat trashëgojnë nga njëri brez në tjetrin. Ky fakt sjell pasoja në gëzimin e pronës nga gratë, të cilat edhe në rastet kur trashëgojnë, barazohen me fëmijët e tyre, duke u ndarë e gjithë prona në mënyrë të barabartë ndërmjet gruas dhe fëmijëve. Mentaliteti dhe frika nga paragjykimet vijojnë të jenë disa elementë që ndikojnë te gratë dhe vajzat dhe i pengojnë ato për të kërkuar dhe gëzuar pronat e tyre. Këto paragjykime bëhen pengesë edhe për të kërkuar regjistrimin e grave në pronësitë e fituara përgjatë martesës. Për më keq, paragjykimet i shtyjnë shpesh gratë të dhurojnë pronë, si dhe të mos kuptojnë vlerën e punës së tyre për mbarëvajtjen e punëve të shtëpisë, kujdesit për fëmijët, për të moshuarit etj. Këto takime nxorën në pah domosdoshmërinë e vijimit të sesioneve të tilla informuese dhe rëndësinë e edukimit

ligjor për gratë/vajzat mbi të drejtat e tyre pronësore. Nga intervistimet e vajzave u bë e qartë se kjo qasje nuk zhvillohej as në ndonjë nga kurrikulat mësimore në shkolla.

1.2 Organizimi takimeve derë më derë. Gjetjet.

Me qëllim ndërgjegjësimin, informimin dhe edukimin ligjor të qytetarëve janë organizuar 80 takime me përfitues derë më derë, në Bashkitë Durrës, Kavajë, Lezhë, Mirditë, Shijak dhe Tiranë. Këto takime janë realizuar nga juristët e rinj të angazhuar në këtë projekt. Këta kanë identifikuar në terren gratë dhe vajzat e prekura nga tërmeti dhe kanë organizuar aktivitetet në bashkëpunim me aktorët lokalë, si koordinatorët e dhunës në familje, organizatat jofitimprurëse, punonjës të pushtetit vendorë, me të cilët, stafi i Qendrës ka realizuar 10 (dhjetë) takime.

Gjetjet nga takimet derë më derë. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve juristët e rinj kanë evidentuar se gratë dhe vajzat nuk kanë njohuri për legjislacionin e posaçëm për rindërtimin dhe të drejtat e tyre. Prandaj, juristët i kanë këshilluar, informuar, asistuar gratë, vajzat dhe familjarët e tyre. Gjithashtu, i kanë ndihmuar për mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm për të përfituar nga programet e rindërtimit,

Në vazhdimësi, avokatët e Qendrës kanë ndjekur hap pas hapi procesin e aplikimit, plotësimin e dokumentacionit, si dhe ofrimin e shërbimeve ligjore falas për 34 (tridhjetë e katër) qytetarë, të dhënat e të cilit janë përmbledhur në tabelën në vijim.

Të dhënat e mësipërme janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Qytetet	Numri i takimeve/ përfituesve	Rastet që kanë përfituar NJ falas
Durrës	10	7
Kavajë	10	4
Lezhë	10	2
Mirditë	10	4
Shijak	10	2
Tiranë	30	15
Totali	80	34

Tabela nr. 2

2. Garantim i ndihmës juridike falas

Aksesi në drejtësi nëpërmjet ndihmës juridike falas që i është ofruar grave dhe familjeve të prekura nga tërmeti gjatë zbatimit të projektit, ka qenë një nga aspektet më të rëndësishme të tij.

Ndihma juridike falas ka konsistuar në ndihmë juridike parësore, dytësore si dhe në përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore.

Aktivitetet e zhvilluara gjatë projektit kanë shërbyer për të identifikuar raste të grave dhe vajzave që kanë pasur nevojë për shërbim ligjor falas lidhur me çështjet post tërmet, si dhe problematika të tjera me ndikim në gëzimin e qetë të pronave.

2.1 Ofrimi i ndihmës juridike parësore

Gjatë zbatimit të projektit në periudhën 23 qershor 2021 – 31 gusht 2022 kanë përfituar ndihmë juridike parësore 252 (dyqind e pesëdhjetë e dy) qytetarë, kryesisht gra dhe vajza, të cilat janë asistuar dhe mbështetur me shërbime ligjore falas. Ndihma juridike parësore është ofruar për 219 (dyqind e nëntëmbëdhjetë) gra, 7 (shtatë) vajza të mitura, 21 (njëzetë e një) burra dhe 5 (pesë) djem të mitur.


Nëse i ndajmë të dhënat e këtij shërbimi sipas viteve rezulton se:

Në vitin 2021 kanë përfituar ndihmë juridike parësore 90 (nëntëdhjetë) qytetarë, të cilët kanë përfituar 93 (nëntëdhjetë e tre) këshillime ligjore dhe janë përgatitur 8 (tetë) akte.

Në vitin 2022 kanë përfituar ndihmë juridike parësore 162 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy) qytetarë, të cilët kanë përfituar 299 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) këshillime ligjore, janë përgatitur 44 (dyzetë e katër) akte dhe janë përfaqësuar 10 qytetarë në organet administrative.

Nga Grafiku i mëposhtëm duket qartë roli që ka informimi për rritjen e numrit të qytetarëve që përfitojnë ndihmë parësore. Në vitin e dytë të projektit, si rezultat i punës ndërgjegjëse dhe asaj kokë më kokë, është rritur ndjeshëm numri i tyre.

Grafiku Nr. 2



2.1.1 Lloji i ndihmës juridike parësore i ofruar

Ndihma juridike parësore është dhënë në formën e këshillimit dhe qytetarët kanë përfituar në total 392 (treqind e nëntëdhjetë e dy) këshillime. Disa qytetarë kanë përfituar këshillim ligjor më shumë se një herë për **çështje me të njëjtin objekt ose për çështje të tjera**.

Gjithashtu, përfituesit janë asistuar në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore nga të cilat, lidhur me rastet e rindërtimit kanë përfituar 20 (njëzetë) qytetarë dhe për raste të tjera administrative kanë përfituar 22 (njëzetë e dy) qytetarë. Në lidhje me shërbimin ligjor parësor për të kërkuar ndihmë juridike dytësore kanë përfituar 10 (dhjetë) qytetarë. Në total kanë përfituar nga kjo formë e ndihmës juridike parësore, 52 qytetarë.

Për përfaqësimin përpara organeve administrative kanë përfituar 10 (dhjetë) qytetarë.

Të dhënat e mësipërme ndodhen të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

Lloji i ndihmës juridike parësore	Totali
Dhënia e këshillimit	392 qytetarë
Dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore	52 "
Përfaqësim përpara organeve administrative	10 "

Tabela nr. 3

2.1.2 Objekti i çështjeve të ndihmës juridike parësore

Në mënyrë të përmbledhur do të parashtrojmë objektin e çështjeve për të cilat është garantuar ndihmë juridike parësore nga avokatet e Qendrës. Kryesisht, qytetarët kanë kërkuar informacion dhe janë këshilluar lidhur me procesin e rindërtimit për të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në legjislacion, si dhe për të drejta të tjera pronësore që lidhen me regjistrimin e pronës, legalizimin, njohjen pronarë, çështje të dhunës në familje, zgjidhjen e martesës etj.

Ndihma juridike parësore falas është ofruar për 272 (dyqind e shtatëdhjetë e dy) çështje². Konkretisht, 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) çështje administrative, nga të cilat 79 (shtatëdhjetë e nëntë) çështje kanë pasur objekt përfitimin nga programet e rindërtimit; 79 (shtatëdhjetë e nëntë) çështje civile nga të cilat 71 (shtatëdhjetë e një) çështje lidhen me të drejta të tjera pronësore; 51 çështje familjare (pesëdhjetë e një) dhe 4 (katër) çështje penale.

Objekti i çështjeve është paraqitur në paragrafët që vijojnë.

E drejta Administrative - 138 çështje

- Përfitim nga programet e rindërtimit - 79 çështje.
- Përfitim nga programet e strehimit social - 20 çështje.
- Përfitim nga skema e ndihmës ekonomike - 8 çështje.
- Përfitim nga pagesat e aftësisë së kufizuar - 9 çështje.
- Të ndryshme - 22 çështje.

E drejta Civile - 79 çështje

- Pronësore të ndryshme - 34 çështje.
- Regjistrim pasurie dhe marrja e certifikatës së pronësisë - 16 çështje.
- Trashëgimore - 14 çështje.
- Legalizim i ndërtimeve informale - 8 çështje.
- Civile të ndryshme - 7 çështje.


E drejta Familjare - 51 çështje.

- Zgjidhje martese - 21 çështje.
- Dhunë në familje - 8 çështje.
- Njohje atësie dhe kundërshtimi i atësisë së prezumuar - 4 çështje.
- Çështje kujdestarie (vendosje dhe heqje) - 5 çështje.
- Këshillim mbi ligjin për statusin e jetimit - 5 çështje.
- Familjare të ndryshme - 8 çështje.

E drejta Penale - 4 çështje

Në përqindje, objekti i çështjeve paraqitet i përmblodhur në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku Nr. 3



² Një qytetarë ka përfituar më shumë se një herë ndihmë juridike parësore për çështje të ndryshme

2.2 Ofrimi i ndihmës juridike dytësore


Ndihmë juridike dytësore kanë përfituar 30 (tridhjetë) qytetarë, për të cilët janë redaktuar 17 (shtatëmbëdhjetë) kërkesë padi, një nga të cilat lidhet me procesin e rindërtimit, është garantuar përfaqësimi në gjykatë dhe në prokurori në 9 (nëntë) çështje dhe janë këshilluar në mënyrë të vazhdueshme qytetarët lidhur me procesin gjyqësor, të drejtat dhe detyrimet etj.

Nëse i ndajmë të dhënat e këtij shërbimi sipas viteve rezulton se:

Në vitin 2021 kanë përfituar ndihmë juridike dytësore 10 (dhjetë) qytetarë, të cilëve i janë hartuar 5 (pesë) akte dhe janë përfaqësuar në 2 (dy) raste.

Në vitin 2022 kanë përfituar ndihmë juridike dytësore 20 (njëzetë) qytetarë, të cilëve i janë hartuar 12 (dymbëdhjetë) akte dhe janë përfaqësuar në 7 (shtatë) raste.

Grafiku Nr. 4



2.3 Përfundimi nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore

Qytetarët kanë pasur mundësi që nëpërmjet shërbimit ligjor falas të përfitojnë në 5 raste me vendim gjyqësor përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore si dhe avokatin falas.

2.4 Gjetje dhe konkluzione të evidentuara nga avokatët gjatë ofrimit të shërbimit ligjor falas.

Avokatët e Qendrës që kanë ofruar ndihmë juridike falas kanë evidentuar problematika që lidhen me të drejtat pronësore dhe me procesin e rindërtimit të cilat po i përmbledhim si më poshtë vijon:

- Qytetarët kanë mungesë informacioni lidhur me legjislacionin për rindërtimin e pronave të prekura nga tërmeti.
- Pronat vijnë të jenë të regjistruara vetëm në emër të burrave (bashkëshorti, vjehrrri, djali).
- Nuk janë përcaktuar kritere të qarta për mënjanimin e pabarazive që krijohen midis qytetarëve të dëmtuar që kanë bashkëpronësi. Personat që kanë më shumë se një apartament banimi e humbasin pronën jo vetëm mbi apartamentin, por edhe mbi truallin.
- Mungesë besimi kundrejt institucioneve për procesin e rindërtimit të banesave. Përfituesit e programeve të rindërtimit kërkojnë të përfitojnë të njëjtin numër pronash që kanë pasur përpara dëmtimit nga tërmeti, duke pretenduar se shteti duhet t'i rindërtojë ato siç ishin.
- Problematikë vijon të mbetet çështja e regjistrimit të pronave që do të rindërtohen, ku gratë duhet të tregojnë kujdes që gjatë procedurave përpara noterit të jenë prezent me qëllim që prona të regjistrohet edhe në emër të tyre në cilësinë e bashkëpronares.
- Ka raste të trajtimit jo të barabartë të pjesëtareve të një familjeje që kanë jetuar në të njëjtën banesë duke mundësuar aplikime sipas përbërjeve familjare.
- Mungesa e dokumentacionit të pronave ka sjell tejzgjatje të procesit apo edhe mos vazhdim të tij, si dhe raste kur qytetarët i janë drejtuar gjykatës për të vërtetuar faktin që kanë qenë posedues të pronës. Mungesa e dokumentacionit në dosje ka ndikuar edhe në mos kualifikimin e subjekteve përfitues.
- Shohim një problem në rastet kur kërkohet konfirmimi i pjesëtarëve madhorë të familjes edhe në rastet kur nuk janë pronarë dhe prona nuk ka qenë në proces legalizimi, apo në rastet kur këta duhet të nënshkruajnë deklarata noteriale sipas të cilës, nuk kanë asnjë pretendim lidhur me pronën. Duhet të përcaktohet qartë se me çfarë procedure zhvillohet kjo, dhe për më tepër të gjitha procedurat duhet të jenë të unifikuara.
- Ka rezultuar se një nga pasojat e fitimit të pronësisë pas procesit të rindërtimit është ndryshimi i gjendjes pronësore të mëparshme. Në bazë të legjislacionit, përfitimi i sipërfaqeve të pronave të paluajtshme pas procesit të rindërtimit do të kryhet sipas përbërjes familjare, pra në bazë të frymëve në familje dhe jo në bazë të sipërfaqeve të shkatërruara nga tërmeti. U evidentuan raste kur familje me dy anëtarë ose me pak anëtarë, përpara tërmetit kanë pasur në pronësi apartamente apo banesa me sipërfaqe të mëdha, ndërkohë që familje të mëdha me shumë frymë kanë jetuar në sipërfaqe të vogla. Në këto raste, ka nevojë për një përgatitje ndërgjegjëse, pasi mund të sjellë edhe konflikte gjyqësore me palën shtetërore në të ardhmen.
- Ka rezultuar se për regjistrimin dhe gëzimin e pronës nga anëtarët e familjes kanë ndikuar çështje që lidhen me faktin që akti i pronësisë rezulton i regjistruar në emër të prindërve që nuk jetojnë më, mungojnë akte të trashëgimisë ligjore apo testamentare, si dhe pamundësia ekonomike për të paguar tarifat gjyqësore dhe shpenzimet avokatore.
- Gratë e familjes, pothuajse në të gjitha rastet e evidentuara, nuk kishin dijeni për faktin që janë bashkëpronare me bashkëshortin dhe e konsiderojnë veten në pozitë jo të barabartë me fëmijët e tyre djem, për të cilët ato mendojnë se duhet të jenë pronarë.

- Përsa u përket vajzave, anëtare të familjes të cilat rezultojnë të martuara, pretendohet se nuk kanë më të drejta mbi pronat nga familja e origjinës.
- Ka pasur të prekur nga tërmeti që kanë hasur edhe problematika të tjera si dhuna në familje, përndjekja, papunësia, mospërfitimi i ndihmës ekonomike etj.
- Në disa raste u evidentua humbja e afateve të aplikimit për të përfituar nga programi i granteve të rindërtimit dhe vështirësia për t'u rivendosur në afat.
- Gjendja familjare e momentit të fatkeqësisë natyrore, sipas certifikatës së gjendjes familjare në datën 26.11.2019 për disa subjekte ka sjellë probleme. Kjo ka ndodhur sidomos kur ka mospërputhje ndërmjet situatës faktike me atë juridike, ku de facto subjekti që pretendon të jetë përfitues nga granti jeton veç dhe de jure figuron në gjendjen familjare të familjes së origjinës.

3. Rritje e kapaciteteve të punonjësve të agjencisë shtetërore të kadastrës, të bashkive e njësive administrative dhe noterëve.

3.1 Organizimi i trajnimeve të kombinuara.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve të punonjësve përgjegjës për procesin e rindërtimit dhe për trajtimin e çështjeve në këndvështrimin gjinor, janë organizuar 9 (nëntë) trajnime të kombinuara në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Lezhës. Gjatë trajnimeve janë zhvilluar tema për të rritur kapacitetet e 128 (njëqind e njëzetë e tetë) profesionistëve, përfaqësues të kadastrës, punonjës të pushtetit vendor të bashkive respektive dhe profesionistë të lirë (noterë, avokatë) etj.

Seksionet trajnuese të mësipërme kanë shërbyer edhe për të diskutuar për praktikën e zbatuar për rindërtimin, unifikimin e tyre, si dhe forcimin e bashkëpunimit të punonjësve shtetërore me profesionistët e lirë. Pjesëmarrësit u informuan dhe shkëmbyen përvoja lidhur me fazat e procesit të rindërtimit, arritjet, sfidat dhe praktikën e ndjekura. U diskutuan bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shtetërore dhe profesionistëve të pavarur, të drejtat pronësore në favor të grave/vajzave në këndvështrimin gjinor, çështje të trashëgimisë dhe të parandalimit të heqjes dorë nga trashëgimia për gratë dhe vajzat, çështje të regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve. Një vend të posaçëm përgjatë trajnimit zuri diskutimi mbi zbatimin e ligjit nr. 7501 dhe problematikat e identifikuar gjatë zbatimit të tij, rrugëzgjdhjet, etj.

Të dhënat e mësipërme janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Qarku	Numri i trajnimeve	Përfituesit
Tiranë	3	42
Durrës	3	43
Lezhë	3	43
Totali	9	128

Tabela nr. 4

3.2 Trajnime (on job) në zyrat e punonjësve. Gjetjet.

Procesi i rritjes së profesionalizmit të zyrtarëve shtetërore të përfshirë në procesin e rindërtimit, ka vijuar nëpërmjet organizimit të trajnimeve on job, në zyrat e punonjësve. Në këtë kuadër janë organizuar 12 (dymbëdhjetë) trajnime në zyrat e punonjësve me qëllim adresimin e problematikave dhe unifikimin e praktikave të punës për punonjësit e bashkive (zyra e rindërtimit dhe drejtoria

ligjore) dhe punonjësit e Kadastrës në aspektin gjinor. Përfitues të këtyre takimeve kanë qenë 72 (shtatëdhjetë e dy) punonjës përgjegjës për procesin e rindërtimit. Trajnimi u krye nga ekspertet e QNL-së me një grup te vogël profesionistësh në zyrat pranë bashkive, në të cilat u bashkuan edhe profesionistë të kadastrës dhe noterë. Këto aktivitete u zhvilluan në grupe të vogla me përfaqësues të përfshirë drejtpërdrejt në çështje që lidhen me garantimin e të drejtave pronësore si dhe me procesin e rindërtimit pas tërmetit. Praktikimi i kësaj forme trajnimi, si një formë e re pune për forcimin e kapaciteteve të punonjësve përgjegjës për rindërtimin, dëshmoi efikasitet në përshtatjen me njohuritë e barazisë gjinore dhe të mosdiskriminimit për shkak të gjinisë. Ishte një trajnim i shpejtë me përvojë reale që shërbeu edhe për shkëmbimin e eksperiencave dhe njohurive midis punonjësve me specialitet të ndryshëm, si administratorë, punonjës socialë, regjistruar, noterë, juristë, avokatë, etj.

Të dhënat në lidhje me trajnimet *on job* janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Qarku	Numri i trajnimeve	Përfituesit
Durrës	2	12
Kurbin	1	13
Lezhë	3	15
Totali	12	72

Tabela nr. 5

Gjatë këtyre trajnimeve janë ngritur për diskutim një sërë çështjesh, si dhe janë parashtruar sfidat dhe vështirësitë, disa nga të cilat po i përmbledhim si më poshtë vijon:

Probleme në lidhje me legjislacionin.

- Disa aspekte të ndryshimeve legislative nuk i përgjigjen ndryshimeve socio-ekonomike dhe evolucionit të shoqërisë ndër vite. Vlen të përmendet nocioni familje bujqësore ku në shumë raste ka humbur si koncept (Kodi Civil / Kapitulli II / Pika B- Bashkëpronësia në tërësi);

Probleme në lidhje me zbatimin e legjislacionit

- Në aktet nënligjore për përfitimet nga procesi i rindërtimit, si pranues i dhurimit mund të paraqitet vetëm kryefamiljari. Në këtë rast, pasuria e fituar me dhurim konsiderohet si pasuri vetjake e tij, në referim të Kodit të Familjes, neni 77/b. Kjo situatë mund të shpjerë në shkelje të legjislacionit më të ri që garanton të drejtat pronësore për gratë, si dhe në shkelje të parimit kushtetues të barazisë gjinore;
- Kalimi i pronësisë nëpërmjet kontratës së dhurimit vetëm në emër të njërit prej bashkëshortëve, sjell cenim të prezumimit ligjor të bashkëpronësisë bashkëshortore, për shkak se kjo pasuri do të konsiderohet pasuri vetjake e atij bashkëshorti që nënshkruan kontratën;
- Në rast se pasuria i kalohet me dhurim vetëm bashkëshortit si aplikues i grantit të rindërtimit të tërmetit, gruaja mund të humbasë edhe të drejtën ligjore për ta kërkuar pjesën e saj takuese, sepse ajo pasuri konsiderohet si pasuri vetjake. Mbi të gjitha, ekziston rreziku që ajo pasuri të tjetërsohet (nëpërmjet dhurimit, shitjes, shkëmbimit, pjesëtimit, ndarjes së pasurisë etj.), nga përfituesi i saj tek të tretët, pa dijeninë dhe pa pëlqimin e bashkëshortes;
- Domosdoshmëria e përfshirjes së bashkëshortes/bashkëshortit si përfitues në procesin e aplikimit dhe më pas gjatë lidhjes/nënshkrimit të kontratës së dhurimit dhe/ose rindërtimit;
- Nuk është përcaktuar edhe klauzola për juridiksionin e gjykatave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- Janë konstatuar raste të heqjes dorë nga trashëgimia për arsye gjinore;

- Agjencitë vendore të kadastrës evidentuan qëndrime të ndryshme në lidhje me aplikimin për lëshimin e dokumenteve të pronësisë (certifikatë, kartë dhe hartë treguese) në rastet kur kemi disa bashkëpronarë.
- Në aktet e gjendjes civile janë konstatuar probleme, pasi certifikata familjare, certifikata personale dhe/ose certifikata e martesës nuk pasqyrojnë kontratat e martesës, kontratat e bashkëjetesës apo kontratat për ndryshim të regjimit pasuror martesor;

Probleme në lidhje me plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e rindërtimit.

- Janë identifikuar probleme në verifikimin e origjinës së pronës në pasuritë e paluajtshme të dëmtuara nga tërmeti, në mënyrën e fitimit të pronësisë, si dhe të bashkëpronarëve;
- Në disa raste mungon lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë;
- Në akte noteriale bashkëshorti i supozuar bashkëpronar nuk nënshkruan si palë mbi pasurinë e paluajtshme, sipas certifikatës së datës së fitimit të pronësisë, duke mohuar të drejtën e bashkëpronësisë në bashkësinë ligjore;
- Probleme lidhur me kërkesat e panevojshme që rrisin koston e qytetarëve në aplikimet pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).
- U konstatua një mos unifikim i dokumentacionit që duhet të përfshihet për të gjithë formularët (DS1/DS2/DS3/DS4, DS5).

3.3 Adresimi i zgjidhjeve për problemet e evidentuara

Në përfundim të aktiviteteve të mësipërme janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm me qëllim adresimin e problematikave tek institucionet përgjegjëse. Konkretisht, u hartua një dokument i përbashkët, që përmban të gjitha sfidat e hasura nga pjesëmarrësit në garantimin e të drejtave pronësore në kuadër të procesit të rindërtimit, i cili u është dërguar 15 (pesëmbëdhjetë) institucioneve në nivel qendror dhe vendor. Ky dokument ka për qëllim unifikimin e praktikave nga punonjësit e Kadastrës, Bashkive, noterëve me qëllim që procedurat të jenë të njëjta, të garantohen të drejtat pronësore të grave dhe vajzave të prekura nga tërmeti, si dhe adresimin e çështjeve që lidhen me hartimin dhe regjistrimin e kontratave të dhurimit.

Organizata UN Women në Shqipëri në bashkëpunim me QNL-në, u dërgoi institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor shkresa ku ka adresuar çështje me rëndësi për garantimin e të drejtave pronësore të grave dhe vajzave të prekura nga tërmeti. Çështjet lidhen me hartimin dhe ndryshimet përkatëse në kontratat e dhurimit me qëllim që gratë dhe vajzat mos të hasin në cenimin e pronave të tyre.

13 (trembëdhjetë) shkresa që sillnin në vëmendje problemet e respektimit të barazisë gjinore u adresuan tek Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Dhomës Kombëtare të Noterisë, Bashkive Tiranë, Durrës, Lezhë, Shijak, Kamzë, Vorë, Mirditë, Rrogozhinë, Kurbin, Krujë dhe Bashkisë Kavajë.

Për të njëjtin objektiv, e njëjta letër e përbashkët u është drejtuar institucioneve të tjera që kanë nën përgjegjësinë e tyre edhe çështje që lidhen me të drejtat pronësore: Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

4. Aktivitete avokuese dhe lobuese me aktorët përgjegjës

Ekspertët hartuan një plan në mbështetje të të drejtave pronësore të grave në zonat e prekura nga tërmeti, veçanërisht të grave dhe vajzave të dëmtuara nga tërmeti. Ky plan synonte realizimin e objektivave të projektit dhe zgjidhjen e problemeve të evidentuara në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse. Mjetet kryesore të planifikuara ishin prezantimi i problemeve dhe propozimet e rrugëve për zgjidhjen e tyre, përmes takimeve, memove, shkresave dhe komunikimit të vazhdueshëm me përfaqësues të këtyre institucioneve etj. Takimet u zhvilluan me zyrtarët përgjegjës për procesin e rindërtimit, profesionistë të lirë, si dhe me organet kushtetuese që garantojnë të drejtat e njeriut.

Konkretisht, u zhvilluan takime me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Kryetaren e Dhomës Kombëtare të Noterisë, përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit, të Ministrisë së Drejtësisë, të institucioneve të pushtetit vendor, të Kadastrës, etj.

Në këto komunikime u diskutuan çështje që lidhen me cenimin e të drejtave pronësore të grave dhe vajzave të prekura nga tërmeti dhe u parashtruan shqetësime për realizimin e dhurimit të pronave të rindërtuara nga tërmeti, vetëm ndaj njërit prej bashkëshortëve. Institucioneve iu bë thirrje që në gjithë veprimtarinë e tyre të mbajnë parasysh se, pasuria e përfituar si rezultat i proceseve të rindërtimit, duhet të kalojë në pronësi të bashkëshortëve dhe jo në pronësi të “Kryefamiljarit” ose të “Aplikuesit”, sikurse është konceptuar deri tani. Në rast se pasuria i kalohet me dhurim vetëm bashkëshortit, si aplikues për grantin e rindërtimit, bashkëshorti/ja tjetër mund të humbasë edhe të drejtën ligjore për ta kërkuar pjesën e saj takuese, sepse ajo pasuri konsiderohet si pasuri vetjake. Mbi të gjitha, ekziston rreziku që ajo pasuri të tjetërsohet (nëpërmjet dhurimit, shitjes, shkëmbimit, pjesëtimit, ndarjes së pasurisë etj.), nga përfituesi i saj tek të tretët, pa dijeninë dhe pa pëlqimin e bashkëshortes.

Prandaj, në këto takime e komunikime u theksua nevoja e përmirësimit të akteve nënligjore që zbatohen për procesin e rindërtimit. Konkretisht u tërhoq vëmendja në faktin se, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, *“Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”*, i ndryshuar; i referohet si përfitues i grantit të rindërtimit të tërmetit vetëm aplikuesit. Kjo mund të korrigjohet për t’iu përgjigjur legjislacionit duke kërkuar detyrimisht certifikatën e përbërjes familjare të tij, të datës së dëmtimit të tërmetit.

Një problem tjetër që u shtrua për zgjidhje me institucionet përgjegjëse, ishte problemi që krijohej për shkak të ndryshimeve që kishin ndodhur në gjendjen familjare gjatë periudhës nga paraqitja e aplikimit deri në datën e përfitimit të pasurisë si rezultat i procesit të rindërtimit. Çdo ndryshim i gjendjes familjare të aplikuesit, pas datës 26.11.2019, të tilla si: divorc, ndërrimi i jetës së tij ose të bashkëshortes së tij, martesë tjetër, etj., nuk i heq të drejtën as aplikuesit dhe as bashkëshortes/ish-bashkëshortes, për të përfituar pasurinë e paluajtshme si shkak i granteve të rindërtimit të tërmetit.

Përfaqësuesit e institucioneve ndanë me ne opinionin e përbashkët se, kalimi i pronësisë tek "Aplikuesi" ose "Kryefamiljari", mund të sjellë mohimin e të drejtës së bashkëpronësisë ndaj bashkëshortit tjetër dhe në praktikë, mund të sjellë konflikte, për shkak të efekteve të rënda sociale për gruan, të cilës i mohohet bashkëpronësia mbi pasurinë e përfituar gjatë martesës.

Në takime, u trajtuan edhe probleme të tjera, të cilat u identifikuan gjatë projektit, sidomos çështje që lidheshin me zbatimin e legjislacionit në procesin e rindërtimit post-tërmetit, mënyrën e administrimit të dokumentacionit nga ana e pushtetit vendor, si dhe realizimin e kontratës së dhurimit.

Nga ana e ekspertëve u përgatitën informacionet dhe dokumentet e nevojshme me qëllim lobimin në institucione për sa më sipër. Konkretisht, u dorëzuan materialet e përgatitura në institucionet si më poshtë:

- 1) Dërgimin e informacionit dhe materialeve që do të shërbejnë për marrjen e masave nga institucionet e Ministrisë së Rindërtimit, asaj të Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale;
- 2) Dërgimin e informacionit dhe materialeve që do të shërbejnë për marrjen e masave nga institucionet e Avokatit të Popullit dhe institucionit të KMD-së;
- 3) Dërgimin e informacionit dhe materialeve që do të shërbejnë për marrjen e masave nga institucionet vendore në të gjitha bashkitë;
- 4) Dërgimin e informacionit dhe materialeve që do të shërbejnë për marrjen e masave nga institucioni i Kadastrës.
- 5) Dërgimin e informacionit dhe materialeve që do të shërbejnë për marrjen e masave nga institucioni i Dhomës Kombëtare të Noterisë.
- 6) Përgatitja e pesë kontratave të dhurimit TIP për çdo rast të identifikuar gjatë takimeve, përkatësisht: (a) kontratë dhurimi kur dy bashkëshortët janë prezentë; (b) kontratë dhurimi ku njëri nga bashkëshortët nuk është prezent; (c) kontratë dhurimi kur prona ka pasur disa bashkëpronarë ose dy apo më tepër kurora tek një pronë dhe mund të jenë të martuar; (d) kontratë dhurimi, ku prezent janë të dy bashkëshortët dhe pjesëtarët e tjerë të familjes (fëmijët e tyre të cilët dëshirojnë të nënshkruajnë në kontratë); (e) kontratë dhurimi, ku prezent kemi dy kryetarët e familjes me certifikata të ndryshme, por kanë deklaruar se janë dy kurora (ose më tepër) dhe e përfitojnë në favor të bashkësisë ligjore.

4.1. Takime dhe komunikime me organet kushtetuese që mbrojnë të drejtat e njeriut

Ekspertët organizuan takime dhe komunikime me përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit, dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. Robert Gajda. Përpos parashtrimin të situatës në këto komunikime u diskutua mbi mjetet që këto institucione mund të zbatojnë, me qëllim që të ndikojnë institucionalisht në zgjidhjen e situatës. Për këtë ishte e nevojshme që

institucionet përgjegjëse, jo vetëm duhet të viheshin në dijeni me problemet që kemi renditur më sipër, por edhe të ndikoheshin përmes institucioneve që mbrojnë të drejtat e shtetasve, me qëllim që të kryenin ndryshimet e nevojshme në aktet nënligjore dhe në praktikat e tyre institucionale, për të respektuar të drejtat pronësore në këndvështrimin gjinor. Në përgjigje të kësaj nisme, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u përgjigj me rekomandimin përkatës, të cilin po e përmbledhim në vijim.

Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi ka adresuar disa sugjerime në lidhje me procesin e hartimit të kontratave të dhurimit për banesat e përfituara nga grantet e rindërtimit si pasojë e dëmtimeve të tërmetit të vitit 2019³. Në këndvështrimin e Komisionerit duhet të mbahet në vëmendje statusi martesor dhe bashkësia ligjore, deri në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë natyrore. Kur prona e shkatërruar nga tërmeti ka qenë pjesë e bashkësisë ligjore, përfitimi vetëm nga njeri bashkëshort nëpërmjet kontratës së dhurimit, do të ishte cenim i të drejtës së pronësisë, barazisë gjinore dhe do të krijonte premisa për diskriminim gjinor. Prandaj, Komisioneri rekomandon:

- Marrjen e masave nga Këshilli i Ministrave për zbatimin e të drejtës pronësore midis të dy bashkëshortëve/ish-bashkëshortëve, në kontratat e dhurimit për banesat e përfituara nga grantet e rindërtimit si pasojë e ndërtimeve të tërmetit të vitit 2019 edhe në rastet kur paraqitet njëri prej bashkëshortëve.
- Marrjen e masave nga Bashkitë/Njësitë e Qeverisjes vendore dhe Noterët që të dy bashkëshortët/ish-bashkëshortët të përfshihen në kontratat e dhurimit për banesat e përfituara nga grantet e rindërtimit si pasojë e ndërtimeve të tërmetit të vitit 2019, edhe në rastet kur paraqitet njëri prej bashkëshortëve.

Këto rekomandime u janë adresuar Këshillit të Ministrave, Dhomës Kombëtare të Noterisë, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe të gjitha Bashkive që po punojnë me procesin e rindërtimit post tërmetit të vitit 2019.

4.2. Takim me përfaqësues të pushtetit qendror

Në korrik të vitit 2022 janë zhvilluar disa takime të ekspertëve me përfaqësuesit e organeve të pushtetit qendror. Një rëndësi të posaçme pati takimi dhe komunikimi i vazhdueshëm me Përgjegjësin e Sektorit të Profesioneve të Lira, përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë. Në këto takime grupi i punës diskutoi për mënyrën e administrimit të dokumentacionit nga ana e pushtetit vendor, si dhe për kontratat e dhurimit, të cilat në praktikë sjellin efekte të rënda sociale për gruan, pasi mohojnë gjysmën e prezumuar të bashkëpronësisë mbi pasurinë e përfituar gjatë martesës. Ekspertët rekomanduan sugjerime konkrete për hartimin e kontratave të dhurimit, të cilat duhet të konsiderohen nga noterët, si dhe nga DHKN. Përfaqësuesi i MD-së theksoi se Ministria e Drejtësisë është e gatshme dhe e disponueshme që në një afat kohor shumë të shkurtër të përcjellë shkresën rekomanduese tek DHKN-ja dhe noterët, me qëllim zbatimin e rekomandimit. U theksua se ky rekomandim është i rëndësishëm dhe duhet zbatuar, në të kundërt, në rastin e moszbatimit të tij do të merren masat ligjore.

3 Shih: Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, "Sugjerime ...në lidhje me procesin e hartimit të kontratave të dhurimit për banesat e përfituara nga grantet e rindërtimit si pasojë e dëmtimeve të tërmetit të vitit 2019", Tiranë, 2022

4.3. Takime me përfaqësues të pushtetit vendor

Në kuadër të këtij aktiviteti janë realizuar 11 (njëmbëdhjetë) takime në Bashkitë Lezhë, Rrëshen, Tiranë, Durrës, Shijak, Kavajë, Kurbin, Rrogozhinë, Vorë, Kamzë dhe Krujë. Ekspertet e QNL-së kanë realizuar takime me 137 (njëqind e tridhjetë e shtatë) përfaqësues të strukturave të rindërtimit, komisioneve të posaçme të rindërtimit, të drejtorive juridike, etj. Në këto takime janë diskutuar mundësitë e marrjes në konsideratë të sugjerimeve të QNL-së dhe të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbi aspektet gjinore në procesin e lidhjes/nënshkrimit të kontratave të dhurimit për banesat e përfituara nga grantet e rindërtimit.

Takimet janë shoqëruar nga një proces vazhdimi e monitorimi në lidhje me zbatimin e çështjeve që janë evidentuar nga të gjitha aktivitetet e projektit dhe në mënyrë të veçantë nga takimet dhe hapat konkrete në zbatimin e tyre. Në takime u veçuan praktikat më të mira që janë ndjekur nga disa bashki për t'i ndarë edhe me bashki të tjera, veçanërisht në rastet e trajtimit të familjeve që janë vulnerabël, që trajtohen me ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, gratë e divorcuara etj. Gjatë komunikimit me organet vendore u shtrua nevoja për të organizuar sa më parë një takim me Ministrin e Rindërtimit ose drejtues në këtë ministri, përpara ndarjes së kontratave, me qëllim që të vijojnë përpjekjet për mbrojtjen e interesave të grave, përmes hartimit të kontratave tip tek Ministria e Rindërtimit. Gjithashtu, u identifikua nevoja për të bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për të arritur këto qëllime. Në të gjitha takimet, përfaqësuesit e bashkive dhe ekspertët e advokacisë dakordësuan se do të dërgohen kontratat tip, si dhe do të ndiqet procesi i zbatimit të tyre, jo vetëm në rastet e propozuara por edhe në ato raste që janë specifike. Në përfundim u dakordësua se do të njoftohen përfaqësuesit e bashkive përkatëse, lidhur me çdo zhvillim në komunikimin me Ministrinë e Rindërtimit. Por, kjo e fundit nuk u përgjigj dhe nuk u angazhua në asnjë prej aktiviteteve të projektit.

4.4. Takime me përfaqësues të drejtorive vendore të kadastrës

Grupi i ekspertëve u angazhua në mbështetje të drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim që në të gjitha rastet që do të bëheshin aplikime për regjistrimin e kontratave të dhurimit të regjistroheshin dhe të pajiseshin me certifikata pronësie të dy bashkëshortët. Në këtë kuadër janë realizuar takime dhe komunikime të vijueshme përkatësisht me Drejtorin e Drejtorive Vendore të Kadastrës Lezhë dhe Rrëshen. Në takim u diskutuan çështje të ndryshme që lidhen me procesin e rindërtimit por edhe problematika të tjera që hasin gratë pranë këtij institucioni në garantim të të drejtave të tyre. Drejtori i drejtorisë vendore të kadastrës Rrëshen u shpreh i gatshëm të regjistronte dhe të pasqyronte në rastet e transaksioneve pronësinë si në kontratë, si dhe të zbatonte sugjerimet e parashtruara në shkresën e ASHK-së.

Në të gjitha takimet u sollën në vëmendje parashikimet e ligjit “Për Kadastrën”, të cilat zbatojnë të drejtat gjinore për gratë, me qëllim që të zbatohen përgjatë regjistrimit të pronësisë.

U nënvizua që të gjitha institucionet, jo vetëm ato të Kadastrës, të zbatojnë nenin 45/1, 2 të ligjit Nr.111/2018 “Për Kadastrën”, i cili ka parashikuar shprehimisht:

“ 1. Nëse pasuria, objekt i kontratës së kalimit të pronësisë, realizuar në favor të personave fizikë, të cilët në regjistrin e gjendjes civile kanë statusin e të martuarit, është pasuri e fituar gjatë martesës, në përputhje me nenin 76, të Kodit të Familjes, regjistrimi në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë bëhet në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve, për sa kohë ata nuk provojnë se i nënshtrohen një regjimi pasuror martesor të veçantë.

2. Drejtoria vendore korrigjon ose përditëson të dhënat kadastrale për pasuritë e paluajtshme në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve, të fituara gjatë martesës përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, në rast se kjo kërkohet me shkrim nga bashkëshorti që nuk është i regjistruar dhe vërtetohet nga certifikata e gjendjes familjare në kohën kur është fituar pasuria.”

4.5. Takim me kryetaren e Dhomës Kombëtare të Noterëve

Ekspertët QNL-së organizuan një komunikim të vazhdueshëm me Zj. Mimoza Sadushaj, Kryetare e Dhomës Kombëtare të Noterëve, me të cilën diskutuan shqetësimet dhe sugjerimet e QNL-së, lidhur me përfshirjen e bashkëshortes në procesin e nënshkrimit të kontratave të dhurimit. DHKN-ja dhe ekspertët e QNL-së së bashku, përpunuan një plan komunikimi me institucionet e tjera si MD, ASHK, dhe MR, me qëllim bashkërendimin e përpjekjeve për të realizuar këtë qëllim. Duke konsideruar rekomandimet e QNL-së, DHKN-ja do të përgatisë një udhëzim për noterët, si dhe do të bëjë të njohur për ta edhe manualin e hartuar nga ekspertët për këtë qëllim të përbashkët.

4.6. Hartimi i manualit për juristët⁴.

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara për mbështetjen dhe lobimin, është hartuar dhe Manuali për Juristët “Të drejtat pronësore për gratë në grantet e rindërtimit pas tërmetit të vitit 2019”. Ky manual i shërben çdo profesionisti të ligjit e në veçanti atyre që janë të angazhuar në procesin e rindërtimit. Manuali është hartuar me qëllim që t’u shërbejë juristëve e punonjësve për gjetjen e zgjidhjeve juridike në rastet praktike të kalimit të së drejtës së pronësisë në emër të përfituesit nga granti i rindërtimit të tërmetit. Konsultimi i juristëve me këtë manual të shkurtër praktik, përveçse do të ndihmojë në mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave të dëmtuara nga tërmeti, me qëllim parandalimin e konflikteve të mundshme gjyqësore në të ardhmen, do të ndihmojë edhe në zgjidhjen efektive të tyre në rrugë administrative, pa angazhuar rrugën gjyqësore. Në mënyrë të veçantë ky manual do të ndihmojë noterët që hartojnë kontratat për kalimin e pronësisë, punonjësit e kadastrës të cilët kryejnë regjistrimin e pasurisë që fitohet nga grantet e rindërtimit të tërmetit, si dhe punonjësit e organeve vendore që asistojnë në të gjithë procesin e aplikimit, mbledhjes së dokumentacionit deri në regjistrimin e pasurisë së paluajtshme.

Në përfundim të realizimit të planit të mbështetjes dhe lobimit, ekspertët iu dërguan të gjitha ministrive të linjës dhe bashkive kontratat tip të hartuara, të cilat ndodhen në aneksin e këtij raporti.

4.7. Gjetje dhe Konkluzione.

Procesi i lobimit për të drejtat gjinore në kuadër të zbatimit të këtij projekti ishte një nga aktivitetet kryesore të tij. Por, gjatë zbatimit të tij, ekspertët e QNL-së identifikuan disa probleme të cilat u adresuan tek institucionet dhe duhet të mbahen parasysh.

- Legjislacioni përkatës për procesin e rindërtimit post tërmetit nuk ka marrë në konsideratë legjislacionin aktual për barazinë gjinore, veçanërisht Kodin e Familjes dhe ligjin “Për Kadastrën” dhe për rrjedhojë nuk është në përputhje me standardet kushtetuese e ndërkombëtare të barazisë gjinore. Sa kohë që korrigjimi i tij nuk është kryer përmes ndryshimeve ligjore, mund të korrigjohet përgjatë zbatimit të tij në praktikë. Për këtë ishte

4 I vlefshëm në: manual_drejta_pronesore.pdf (qag-al.org)

e nevojshme që të informoheshin dhe të trajnoheshin të gjitha institucionet përgjegjëse me qëllim që të zbatojnë standardet legislative të barazisë gjinore të cilat legjislacioni ynë i ka sanksionuar.

- Përgjatë gjithë aktivitetit të diskutimit dhe lobimit me institucionet shtetërore, ekspertët konstatuan se ka ende përfaqësues të këtyre institucioneve, të cilët nuk njohin legjislacionin në lidhje me respektimin e parimit të barazisë gjinore në veprimtarinë e tyre, e në këtë rast, në lidhje me të drejtat pronësore për gratë e vajzat. Në disa raste u evidentuan edhe koncepte të gabuara.
- Gjatë këtij procesi u konstatua se kishte nevojë për një koordinim më të mirë të veprimtarisë së institucioneve qendrore për rindërtimin, me ato vendore.
- U konstatua se ndërhyrja e institucioneve për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut, si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është shumë e rëndësishme për respektimin e barazisë gjinore, prandaj presioni nga ana e tyre duhet të rritet.
- Krijimi i një rrjeti të koordinuar midis institucioneve respektive mbetet shumë i rëndësishëm, me qëllim unifikimin e akteve dhe veprimeve administrative të institucioneve në respekt të parimit të barazisë gjinore.
- Edhe punonjësit që kryejnë veprimet administrative rutinë kanë nevojë për njohjen e legjislacionit përkatës dhe respektimin e tij në kuadër të dhurimit dhe të regjistrimit të pronave të rindërtuara.
- Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile mbetet shumë i rëndësishëm për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të barazisë gjinore në të drejtat e pronësisë.
- Kontratat e dhurimit që do të hartohen nga noterët duhet me doemos të marrin në konsideratë edhe Kodin e Familjes dhe ligjin “Për Kadastrën”, me qëllim kalimin e pronësisë në favor të të dy bashkëshortëve. Për këtë qëllim shërbejnë edhe dokumentet e manuali i shkruar përgjatë zbatimit të projektit.

5 Angazhimi i juristëve të rinj në aktivitetet e projektit

5.1 Përgatitja e studimit (desk study)

Në kuadër të zbatimit të projektit Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) ka realizuar një studim (*desk study*) i cili ka trajtuar aspekte ligjore dhe praktike të të drejtave pronësore të grave në periudhën post-tërmet. Studimi është përgatitur nga një juriste e re dhe një eksperte e fushës pronësore duke u mbështetur në metodat hulumtuese, përshkruese dhe analizuese. Një kërkim paraprak (*desktop research*) është realizuar për situatën e të drejtave pronësore të grave, legjislacionin në fuqi⁵, si dhe legjislacionin post-tërmet me qëllim identifikimin e akteve ligjore, fazat dhe procedurat e aplikimit për përfitimin nga grantet e rimëkëmbjes. Gjithashtu, u është kërkuar informacion 11 (njëmbëdhjetë) bashkive që mbulojnë zonat e prekura nga tërmeti, në të cilat është shtrirë zbatimi i projektit.

Në përfundim të punës kërkimore me qëllim eliminimin e diskriminimit gjinor në çështjet e të drejtave pronësore dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike të grave dhe vajzave në zonat e prekura nga tërmeti janë dhënë rekomandime konkrete për institucionet përgjegjëse dhe QNL-në. Konkretisht, organet e njësive vendore të ngarkuara për menaxhimin e procesit të rindërtimit, duhet të ndjekin me përpikëri të gjitha procedurat e parashikuara në aktet ligjore. Ndërsa, zyrtarët e kadastrës dhe noterët duhet të kenë një qasje të unifikuar dhe të kombinuar në zbatimin e legjislacionit për të drejtat pronësore. Rekomandohet që QNL të organizojë aktivitete ndërgjegjëse dhe informuese për gratë dhe vajzat lidhur me të drejtat e tyre pronësore, si dhe të ofrojë ndihmë ligjore falas ballë për ballë dhe nëpërmjet mjeteve elektronike në respektim të kushteve të krijuara nga pandemia Covid-19.

Përsa parashtruar më sipër, në referim të kuadrit ligjor të identifikuar dhe përgjigjeve të disa bashkive, ky *desk study* është hartuar, me qëllim që t'u shërbejë juristëve dhe avokatëve në ofrimin e një shërbimi ligjor sa më efektiv, si dhe i ka shërbyer ekspertëve dhe QNL-së për të kërkuar nga institucionet përgjegjëse marrjen e masave konkrete me qëllim garantimin e të drejtave pronësore të grave dhe vajzave të prekura nga tërmeti.

Në këtë studim janë evidentuar dhe analizuar të gjitha aktet ligjore post-tërmet, në lidhje me detyrimet ligjore ekzistuese⁶. Në referim të tyre janë përcaktuar edhe detyrat për zbatimin e mirë të ligjit, të cilat janë mbajtur parasysh edhe në realizimin e këtij projekti.

5 Puna kërkimore është realizuar duke u mbështetur edhe në materialet e përgatitura nga ekspertet e tjera të projektit. Prof. Dr. Av. Aurela Anastasi dhe Dr. Elona Saliaj

6 Një listë e akteve ligjore që janë analizuar në këtë studim, është paraqitur në aneksin 2 të këtij Raporti.

5.2. Takimet derë më derë me gratë dhe vajzat në zonat e dëmtuara nga tërmeti.

Këto takime janë aktiviteti më i rëndësishëm që realizuan juristët e rinj. Përmes tij u identifikuan probleme dhe juristët e rinj dhanë kontributin e tyre për të ndihmuar ligjërisht personat e dëmtuar nga tërmeti. Me më tepër hollësi këto aktivitete janë paraqitur në pikën 1.2. të këtij raporti.

5.3 Organizimi i një trajnimi me juristët/juristët e rinj

Katërmbëdhjetë juristë të rinj u trajnuan për aspekte ligjore dhe praktike të legjislacionit të rindërtimit. Trajnimi ka ndihmuar në rritjen e kapaciteteve dhe aftësive praktike të 14 (katërmbëdhjetë) juristëve të rinj, lidhur me legjislacionin e rindërtimit por edhe për trajtimin e çështjeve pronësore në këndvështrimin gjinor. Ata kanë përdorur informacionin dhe aftësitë për të ofruar ndihmë juridike falas për gratë dhe vajzat e prekura nga tërmeti. Gjithashtu, desk study u shërbeu juristëve që të informoheshin lidhur me çdo aspekt të legjislacionit të ri, por edhe për zbatimin në praktikë të tij.

6. Aktivitete të tjera të organizuara në zbatim të projektit

6.1 Organizimi i një Workshop-i

Nëpërmjet organizimit të një Workshop-i, në Tiranë, më 14 Qershor 2022, QNL-ja mundësoi që për herë të parë aktorët përgjegjës së bashku me profesionistët e lirë dhe shoqërinë civile të diskutonin bashkërisht për procesin e rindërtimit, lidhur me legjislacionin (aspekte teorike dhe praktike të tij), të njiheshin me rezultatet e projektit dhe ndërhyrjet e nevojshme të realizuara, si dhe të adresonin problematikat e evidentuara me qëllim garantimin e aksesit në pronë për gratë dhe vajzat e prekura nga tërmeti.

Konkretisht, 49 (dyzetë e nëntë) pjesëmarrës përfaqësues të institucioneve në nivel vendor, noterë, përfaqësues të Kadastrës, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, juristët dhe avokatët e përfshirë në projekt nën drejtimin e ekspertëve kryesorë të QNL-së ndanë përvojat, njohuritë, rekomandimet dhe sfidat e tyre në lidhje me procesin e rindërtimit në të tre qarqet: Tiranë, Durrës dhe Lezhë. Ky aktivitet kishte si qëllim përmirësimin në vijimësi të procedurave që do të ndërmarrin aktorët përgjegjës në garantim të të drejtave pronësore të grave dhe vajzave të prekura nga tërmeti. Gjithashtu, trajtimi i çështjeve në aspektin gjinor me qëllim eliminimin e diskriminimit gjinor nga institucionet përgjegjëse dhe noterët ishte një aspekt tjetër i synuar. Në këtë aktivitet pjesëmarrësit patën mundësi të ndanin eksperiencat e tyre, sfidat, praktikatat pozitive të cilat u propozuan si rekomandime.

6.2 Retreat i stafit të QNL-së

Dhjetë punonjës të stafit të QNL-së morën pjesë në një *retreat* të organizuar në kuadër të këtij projekti, nëpërmjet të cilit përmirësuan njohuritë dhe kuptimin e tyre mbi të drejtat pronësore në këndvështrimin gjinor për gratë dhe vajzat e prekura nga tërmeti. Diskutimet u orientuan rreth arritjeve dhe sfidave të hasura gjatë zbatimit të këtij projekti dhe në dhënien e zgjidhjeve konkrete. Temat e tjera të diskutuara dhe të analizuara konsistuan në aspekte të zbatimit të procedurave financiare dhe administrative të planit strategjik të veprimit të QNL-së dhe rritja e kapaciteteve të stafit në lidhje me procedurat e prokurimit.

6.3 Përgatitja e raportit përfundimtar

Një aktivitet tjetër i projektit është edhe hartimi i këtij raporti i cili përmban të dhëna sasiore dhe cilësore lidhur me rezultatet e arritura të projektit, problematikat e evidentuara dhe sugjerime konkrete për institucionet përgjegjëse. Ky raport do të shërbejë edhe për aktorët përgjegjës që të përmirësojnë punën e tyre, të unifikojnë praktikatat dhe të garantojnë të drejtat pronësore për gratë dhe vajzat e prekura nga tërmeti.

7. Sfidat e hasura nga QNL gjatë zbatimit të projektit

Gjatë zbatimit të projektit janë evidentuar një sërë sfidash. Sfidat më të mëdha janë evidentuar me ngadalësimin e ecjes së procesit dhe vonesat, si dhe për shkak të mosgatishmërisë për bashkëpunim efikas nga Ministria e Rindërtimit.

Procesi i rindërtimit ka qenë një proces në vijimësi dhe ka ndeshur vështirësitë e veta. Shpërndarja e banesave të reja ka filluar vetëm në fund të muajit nëntor 2021 në disa bashki (Vaçar), për pak qytetarë. Edhe mënyra tjetër e mbështetjes që ka qenë nëpërmjet disbursimit të fondeve, ka ndeshur në vështirësi. Në disa njësi administrative nuk janë disbursuar fondet, duke sjellë pakënaqësi dhe zhgënjim të qytetarëve. Në fund të muajit dhjetor janë dhuruar shtëpi/banesa të reja në disa bashki dhe njësi administrative si Kurbin, Kavajë, Fushë-Krujë, Laç, Bubq. Në disa njësi administrative qytetarët kanë hyrë në shtëpitë e reja, por procesi i dhurimit është ende i papërfunduar. Kontratat e dhurimit nuk janë nënshkruar ende dhe procesi i nënshkrimit ende nuk ka filluar.

Ministria e Rindërtimit për shkak të një riorganizimi nga Këshilli i Ministrave u suprimua, fakt që mund të shkaktojë vonesa në procesin e rindërtimit. Institucionet nuk kanë hartuar ende kontratat tip, sipas akteve nënligjore në fuqi. Aktet ligjore dhe nënligjore kanë lejuar versione të ndryshme interpretimi, të cilat kanë sjellë cenim të të drejtave pronësore për qytetarët në tërësi dhe për gratë dhe vajzat në veçanti. Rihapjet e thirrjeve për aplikime kanë krijuar vonesa e kanë sjellë pengesa dhe qasje të dyfishtë nga pushteti vendor.

8. Përfundime të projektit dhe rekomandime

Për sa kemi parashtruar më sipër nëpërmjet aktiviteteve të projektit janë arritur një sërë rezultatesh që konsistojnë në:

- Rekomandim nga Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi;
- U rrit aksesin e grave dhe vajzave të dëmtuara nga tërmeti në sistemin e drejtësisë;
- U rrit ndërgjegjësimin e grave dhe vajzave mbi të drejtat e tyre pronësore, mjeteve ligjore dhe gëzimin e këtyre të drejtave;
- U rritën kapacitetet u forcua më tej koordinimi midis funksionarëve shtetërorë dhe profesionistëve të lirë, me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor.
- U rrit mbështetja e institucioneve përgjegjëse marrë në konsideratë edhe zgjidhjet konkrete.
- Mbetet për t'u mbajtur në vëmendje të institucioneve zgjidhja e problemeve që mund të bëhen shkak për cenimin e të drejtave pronësore për gratë dhe vajzat.
- Do të synohet vazhdimësia e punës, përmes përmbushjes së detyrimeve ligjore për regjistrimin e pronës së dhuruar nga rindërtimi, në emër të të dy bashkëshortëve.

Anex 1.

Procesi i rindërtimit sipas informacioneve të disa bashkive përgjegjëse

Si pjesë e *desk study*-t, si dhe për të orientuar punën e eksperteve lidhur me aktivitetet e tjera të projektit, u është kërkuar informacion 11 (njëmbëdhjetë) bashkive që mbulojnë zonat e prekura nga tërmeti, në të cilat është shtrirë zbatimi i tij. Konkretisht, u jemi drejtuar bashkive Tiranë, Kamzë, Vorë, Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë, Lezhë, Kurbin, Mirditë, dhe Krujë. Qëllimi ka qenë identifikimi i procedurave të ndjekura nga organet përkatëse lidhur me procesin e rindërtimit; numrin e përfituesve nga grantet; ankesave dhe natyrën e tyre si dhe problematikave të hasura gjatë procesit të rindërtimit për aspekte pronësore.

Të dhënat e përpunuara nga informacionet e bashkive po i përmbledhim si më poshtë vijon:

Numri i aplikimeve për të përfituar grante të rindërtimit. Nga përgjigjet e kthyer nga Bashkitë rezulton se në Bashkinë Shijak⁷ kanë aplikuar 508 (pesëqind e tetë) gra për të përfituar nga *grantet* e rindërtimit dhe dëmshpërblimit. Në Bashkinë Kamzë⁸ totali i subjekteve të kualifikuara nga Programi i Rindërtimit është 2368, ndër të cilët 335 (treqind e tridhjetë e pesë) gra. Në Bashkinë Vorë⁹ janë depozituar 1094 (njëmijë e nëntëdhjetë e katër) kërkesa/ankesa (për periudhën 2020-2021). Kwarto i drejtuar Zyrës së Rindërtimit për riverifikimin e dëmeve në banesa për shkak të mosdakordësisë lidhur me vlerësimin e bërë nga Instituti i Rindërtimit Tiranë. Rreth 150 (njëqind e pesëdhjetë) gra trajtohen me *bonus* qiraje. Në Bashkinë Tiranë¹⁰ janë dëmshpërblyer 8883 (tetëmijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre) qytetarë nga *granti* i rikonstruksionit DS1, DS2 DHE DS3.

Procedura e ndjekur. Në lidhje me procedurat e ndërmarra nga bashkitë kemi konstatuar si vijon. Në Bashkinë Vorë¹¹ pas aplikimeve online për të përfituar nga *granti* i rindërtimit, bëhet shqyrtimi i të gjithë dokumentacionit nga grupet e komisioneve përkatëse dhe më pas miratohet nga Këshilli Bashkiak. Në Bashkinë Kurbin¹² në kuadër të procesit të rindërtimit është krijuar Zyra e Posaçme e Rindërtimit, e përbërë nga shtatë anëtarë. Pas verifikimeve të dëmtimeve të banesave nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe aplikimeve në platformën “Shtëpia ime” për të përfituar nga programet e rindërtimit, është bërë shqyrtimi dhe vlerësimi i dosjeve në zbatim të Ligjit Nr. 97/2019 dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Në Bashkinë Durrës, Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike¹³ bazuar në legjislacionin në fuqi që normon përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, i ka mundësuar çdo individ apo familje që të aplikojnë për të përfituar nga procesi i rindërtimit. Për çdo fazë të këtij procesi,

7 Me anë të Shkresës me Nr. Prot. 6272/1, datë 05.11.2021.

8 Me anë të Shkresës me Nr. Prot. 10163/1, datë 03.11.2021.

9 Me anë të Shkresës me Nr. Prot. 7486/1, datë 08.11.2021.

10 Me anë të Shkresës me Nr. Prot. Q-24584/2, datë 12.11.2021.

11 Me anë të Shkresës me Nr. Prot. 7486/1, datë 08.11.2021.

12 Me anë të Shkresës me Nr. Prot. 6434/1, datë 26.11.2021.

13 Me anë të Shkresës me Nr. Prot. 11648/1, datë 12.11.2021.

Bashkia Durrës ka publikuar në faqen zyrtare¹⁴ listat e përfituesve dhe masën e përfitimit për çdo subjekt përfitues sipas vendimeve përkatëse të Këshillit Bashkiak Durrës. Në Bashkinë Lezhë¹⁵ janë krijuar Komisione të Posaçme të Rindërtimit për rindërtimin e banesave.

Bashkia Tiranë. Lidhur me procedurat e ndjekura për procesin e rindërtimit Bashkia Tiranë na informoi¹⁶ se, Këshilli Bashkiak Tiranë ka miratuar vendimin Nr. 57, datë 01.06.2020 "Për përcaktimin e masës së vlerës së rikonstruksionit ose riparimit dhe miratimit të udhëzuesit "Për detajimin e procedurave për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit", të ndryshuar, si dhe vendimin Nr. 70, datë 12.06.2020, "Për miratimin e udhëzuesit "Për detajimin e procedurave për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit", të ndryshuar. Këta udhëzues operacionalë kanë parashikuar faktin se procedura për shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga aplikuesit kalon në dy faza. Faza e parë e aplikimit konsiston në aplikimin e individëve dhe/ose familjeve që kanë pësuar dëme në banesat e tyre nga tërmeti i datës 26.11.2019, pranë njësive administrative/ lagjeve përkatëse ku ata kanë vendbanimin. Pas plotësimit të formularëve dhe dokumentacionit të kërkuar, njësitë administrative dhe lagjet i përcjellin ato pranë strukturave përgjegjëse të Bashkisë Tiranë. Konkretisht, në varësi të statusit të shkallës së dëmtimeve të pasqyruara në formularin e aplikimit, aplikimet e klasifikuara si DS1, DS2, dhe DS3, përcillen nga njësia administrative/lagja në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, ndërsa për aplikimet e klasifikuara si DS4 dhe DS5, i përcillen Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale. Pas shqyrtimit të dokumentacionit nga drejtoritë e lartpërmendura, aplikimet përcillen pranë Komisionit të Posaçëm, i cili asistohet nga sekretariati teknik, që është struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve që përfitojnë nga programet e rindërtimit dhe dokumentacioni kalon më pas për miratim në Këshillin Bashkiak.

Ankesat. Referuar ankesave, Bashkia Shijak dhe Kamzë pohojnë se kanë pasur ankesa kryesisht, lidhur me llojin e vlerësimit të dëmeve, për të cilat janë asistuar nga Instituti i Ndërtimit. Në Bashkinë Kurbin janë paraqitur për shqyrtim 35 (tridhjetë e pesë) ankesa nga qytetarët e skualifikuar nga programet e rindërtimit. Në Bashkinë Lezhë janë paraqitur 108 (njëqind e tetë) ankesa nga qytetarët drejtuar Komisionit të Ankimit në rastet kur kërkesat e tyre nuk janë pranuar nga komisionet e posaçme. Arsytet e mospranimit kanë qenë kur subjektet aplikues nuk vërtetojnë pronësinë për banesën e aplikuar; kur familja ka më shumë se një banesë; kur objekti për të cilin kanë aplikuar ka rezultuar i braktisur, njësi shërbimi ose është i papërfunduar.

Problematikat e evidentuara nga bashkitë. Disa prej bashkive gjatë fazave të ndryshme të procesit të rindërtimit kanë evidentuar problematikat që po i parashtrijmë të përmbledhura si më poshtë vijon:

Lidhur me pronësinë,

- Paraqiten për zgjidhje: rastet e familjeve me dy ose më shumë kurora, me certifikata familjare më vete, por dokumenti i pronësisë rezulton në emër të njërit prej anëtarëve të familjes ose banesa është në emër të prindërve me gjendje civile të ndarë nga fëmijët;
- Rastet e familjeve që jetojnë në objekte me një kulm të përbashkët, ku ndërhyrja në njërin pjesë të objektit të dëmtuar ka shkaktuar dëme edhe në pjesën tjetër të objektit të padëmtuar nga tërmeti.

¹⁴ www.durres.gov.al

¹⁵ Me anë të Shkresës me nr. Prot. 18629/1, datë 01.12.2021.

¹⁶ Me anë të Shkresës me Nr. Prot. Q-24584/5, datë 16.11.2021.

- Mungesa e dokumentacionit të pronësisë si dhe çdo dokumenti që vërteton lidhjen me pronën; Kanë banesa private pa dokumente pronësie dhe të padeklaruara për legalizim;
- Banesa për të cilën është aplikuar është objekt konflikti gjyqësor;
- Mospërputhja e titullarit të dokumentit të pronësisë me personin që ka kryer aplikimin.
- Rastet kur aplikuesit kanë në zotërim dy ose më shumë apartamente, ku te njëri nga apartamentet banojnë fëmijët, por si pronësi vazhdon të jetë në emër të prindërve;
- Nuk kanë përfunduar procesin e privatizimit; p.sh., kanë vetëm autorizim për futjen në apartament nga ndërmarrjet;
- Kanë një objekt tjetër të padëmtuar, por më i vogël se normat e strehimit të familjes;
- Kanë blerë banesa/apartamente (me deklarata dore ose pa dokumente) dhe prona figuron akoma në emër të pronarit fillestar, i cili mund të ketë edhe pronësi tjetër të padëmtuar;
- Kanë bërë ndarje/divorce, por prona figuron e pandarë, ndërkohë që personat janë familje me vete;
- Jetojnë jashtë shtetit dhe kanë vështirësi për dërgimin e prokurave për të afërmit;
- Prona të vjetra para viteve '90, por që nuk figurojnë në listat e trojeve 01.

Lidhur me akt-konstatimet

- Ka probleme të pozicionit të pronës, janë ngatërruar në terren pozicioni i banesave, fotot e objekteve në disa raste referohen për objektet fqinje;
- Ka objekte të pashpallura të pabanueshme me nivel dëmi DS1-DS3.
- Ka objekte të banueshme me nivel dëmi DS4-DS5.

Procesi i regjistrimit. Bashkitë kanë informuar se procesi i regjistrimit të pronave të dhuruara apo të rindërtuara nuk është realizuar, pasi procesi i rindërtimit nuk ka përfunduar ende.

Anex 2

Aktet ligjore e nënligjore

1. Ligji nr.9062 datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes” (ndryshuar me ligjin nr. 134/2015, datë 5.12.2015).
2. Ligji nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013).
3. Ligji nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish- pronarëve”.
4. Ligji nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizim e banesave shtetërore”.
5. Ligji nr. 111/2018 “Për Kadrastën”.
6. Ligji nr.9482, date 03.04.2006 “Për legalizimin e ndërtimeve pa leje”.
7. Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”
8. Akt normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”
9. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 51, datë 27.1.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit.”
10. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 878, datë 24.12.2019 “Për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të rindërtimit”.
11. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”.
12. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit.”